



Në mbështetje të nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Neni 108 i Ligjit mbi Procedurën Administrative nr.02/L-28, datë 22 korrik 2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, mori:

## V E N D I M

**Për korrigjimin (ndryshimin) e vendimit nr. 634/15, datë 13.07.2015 të BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli”**

1. Korrigjohet (ndryshohet) Vendimit i KSHC- nr. 634/15, datë 13.07.2015 i BRrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli” në pikën I.
2. Korrigjohet (ndryshohet) pika I e vendimit, si në vijim:

Riakreditohet programi i studimit: Transporti dhe telekomunikacioni / Diplomë Profesionale e nivelit 7 sipas KKK (120 ECTS) (me specializimet: Transporti; Siguria rrugore dhe aksidentet; Trafiku postar dhe telekomunikacioni)

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

## Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, dhe kërkesën e BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli” nr. 343/15, datë 21.07.2015, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli”
- MASHT-it,
- Arkivit



---

Dr.sc. Ferdije Zhushi Etemi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë